

Përfytyroni 2014

Drejtoria Arsimore e Filadefias: Ndërton Sistemin e Shkollave Model

23 Shkurt 2009

PUBLIC COMMENT DRAFT

Përmbajtja

Hyrje.....	3
Besimet Themelore të Drejtores së Përgjithshme	5
Parimet Drejtuese.....	5
Ku jemi	6
Suksesi i Nxënësit	7
Përzgjedhjet Cilësore	23
Staf Profesional.....	26
Përgjegjësia e të rriturve	29
Operacione model	31
Hapat e tjerë.....	34

Hyrje

"Nëse ne do të realizonim të gjitha gjërat për të cilat i kemi potencialet e mundëshme, do të habiteshim vërtetë me veten tonë."

– Thomas Edison

Në fillim të këtij viti, rezultatet e pikëve të nxënësve të Filadelfias si brënda dhe jashtë Drejtorisë Arsimore kërkonin nga ne të ndryshonim drejtimin strategjik për shkollat tona për pesë vitet e ardhshme. Pasi rishikuam një sërë komentesh e opinionesh, që ishin grumbulluar gjatë tre muajve, u punua shumë për të seleksionuar, përmbledhur, dhe kategorizuar rekomandimet në një sërë masash, që pershkruajnë qartë çfarë do të synojmë të bëjmë.

Ku plan reflekton një vizion të ndryshëm dhe artikulon një kapitull të ri në historinë e drejtorisë. Objektivat e Deklaratës së Edukimit të Komisionit të Reformës Shkollore shërbejnë si bazament për këtë punë. Ky projekt i parë i planit strategjik të drejtorisë është një përmbledhje e raporteve të ndryshme, rekomandimeve të ekipeve të tranzicionit, mendimet e grupeve të punës, grupeve kryesore, takimet e komunitetit, simpoziumet dëgjimore, ashtu si edhe, mendimet më të mira të stafit të drejtorisë. Është një punë në progres.

Gjatë rrugës, ne arritëm në përfundimin se kishim nevojë për të krijuar një panoramë më të plotë, se çfarë do të arrinim nga këto veprime, domethënëse por të veçuara. Ne zgjodhëm një fjalë për udhëheqjen e mendimeve tona, fjalë, që dhe një fëmijë do ti përgjigjesh me lehtësi: përfytyro!

Përfytyroni shkollat tona në 2014. Kur ne të jemi të sukseshëm në zbatimin e të gjitha strategjive të këtij plani, ne do të shikojmë.....

....një sistem shkollor urban të përsosur, ku mësuesit, drejtorët, prindërit, stafi, bërësit e politikës dhe i gjithë komuniteti sëbashku fokusojnë të gjitha energjitë, përpjekjet, planifikimin dhe zhvillimin, burimet dhe iniciativat, në ndërtimin e një kulture arritjesh të shekullit 21.... ku fëmijët janë gjithnjë në plan të parë, perfeksioni bëhet normë, talenti zhvillohet, mundësitë bëhen të barabarta dhe suksesi matet me përmirësimin gjithnjë më tepër të mësimdhënies dhe mësimin në sistem klasash unike...që rezultojnë në progresin e shpejtë të nxënësit....një sistem shkollor, ku të gjithë nxënësit janë të suksesshëm, familjet kanë shumë zgjedhje, stafi është i shkëlqyer, të rriturit janë më përgjegjës dhe veprimet më të suksesshme, mbështesin të gjithë këtë industri.

Në paragrafët më poshtë të këtij plani strategjik, ju do të gjeni një përshkrim më të detajuar të shkollave në të ardhmen. Ne e kemi organizuar drejtimin e punës tonë në pesë prioritetet të avancuara:

Suksesin e Nxënësit. Ne do të sigurojmë, që nxënësit të diplomohen me aftësi akademike të nevojshme për të dalë me sukses në kolegji, punë dhe jetë.

Zgjedhjet Cilësore. Ne do të ndërtojmë një sistem të shkollave më të mira, ku suksesi mbështetet, shumëfishohet dhe vlerësohet dhe dështimi nuk tolerohet.

Staf të shkëlqyer. Ne do të rekrutojmë, zhvillojmë, dhe mbajmë njërezit më të talentuar, të cilët pasqyrojnë diversitetin e masës së nxënësve tanë.

Përgjegjësia e të rriturve. Ne do të bëjmë të gjithë të rriturit përgjegjës për përcjelljen të premtimeve tona tek fëmijët

Operacione model. Ne do të zhvillojmë një biznes të shkëlqyer, operativ dhe praktika komunikimi, që mbështesin mësimin dhe mësimdhënien, ndërsa ruajmë ato praktika që kanë rezultat, vëmë në jetë ndryshimin dhe prezatojmë rrugë të reja, që ndihmojnë nxënësit tanë të arrijnë suksese.

Nëse në 2014 do të realizojmë ato që përfytyrojmë tani, do të lipset dedikim nga të gjithë ne,- të gjithë ne-, të cilët mund të inkurajojmë, sfidojmë, mësojmë, mbështesim, inspirojmë, dhe i gëzojmë fëmijët. Ne i mirëpresim kontributet tuaja në gjykimin dhe punën tonë.

.....

Besimet themelore të Drejtores së Përgjithshme

Fëmijët janë të parët.

Prindërit janë partnerët tanë.

Fitorja arrihet në klasë dhe lehtësohet nga një drejtim shumë kompetent në mësimdhënie.

Drejtimi dhe përgjegjësia janë çelësat e suksesit.

Kërkohet angazhimi i gjithë komunitetit që të garantojë suksesin e të gjithë shkollave të saj publike.

Parimet Drejtuese

Arritje të larta për të gjithë nxënësit

Shpërndarja e barabartë e burimeve për të gjithë distriktin

Bërja e të gjithë të rriturve përgjegjës për arritjet e nxënësit

Ku jemi

Megjithëse disa shkolla të Filadelfias kanë bërë një progres të rëndësishëm dhe frymëzues në vitet e kaluara, shumë nxënës akoma nuk po përfitojnë nga një edukim i nivelit më të lartë, që ata meritojnë. Të dhënat e mëposhtëme japin një panoramë se ku qëndrojmë dhe sugjerojnë se sa larg qëndrojmë ne si komunitetet për të arritur synimet sfiduese të planit strategjik pesëvjeçar, *Përfytyro 2014*.

SUKSESI I NXENESIT

- 72% Pjesëmarrja e fëmijëve në programet cilësore parashkollore
- 49% Nxënës në nivelin i aftë ose i avancuar në matematikë
- 45% Nxënës në nivelin i aftë ose i avancuar në lexim
- 31% Nxënës nën nivelin bazë në matematikë
- 33% Nxënës nën nivelin bazë në lexim
- 61% Nxënës që diplomohen brenda gjashtë vjetëve
- 23% Diferenca në lexim midis nxënësve të bardhë dhe afro-amerikanë
- 25% Diferenca në lexim midis nxënësve të bardhë dhe Hispanik
- 43% Shkollat që kanë arritur Progresin e Duhur Vjetor, në 2008-tën (*AYP-Adequate Yearly Progress*)
- 29% Numri i shkollave që nuk bëjnë as Progresin e Duhur Vjetor dhe as nuk kanë treguar arritje të mëtjshme achievement growth
- 62% Shkollat vlerësuar me B+ ose më lart në auditimin mbi sigurinë
- 88% Shkollat me Shoqatat Shkollë Familje aktive

Suksesi i Nxënësit

Përfytyroni....

- Të gjithë fëmijët fillojnë kopshtin të gatshëm për mësim dhe e përfundojnë me sukses
- të gjithë fëmijët fillojnë vitin shkollor në nivelin duhur
- Një drejtori arsimore, ku të gjithë nxënësit shkojnë çdo ditë me dëshirë në shkollë
- Të gjithë nxënësit mund të ndjekin programet më të reja në art, muzikë, dhe programet atletike gjatë ditës, mbas shkolle, gjatë verës dhe të shtunave
- Të gjithë nxënësit pajisen me një experiencë pune me mbarimin e klasës së 12^{-të}
- Të gjithë nxënësit, të cilët duan të vazhdojnë shkollat e larta, janë të gatshëm për këtë qëllim.
- Nxënësit, të cilët rrezikojnë të jenë mbetes ose të lënë shkollën identifikohen shpejt dhe u jepet ndihma e duhur për të arritur sukses.
- Nxënësit kanë mundësi të shumta dhe të përshtatshme të ndjekin shkollat dhe të diplomohen

Pershpejtimi i suksesit të nxënësve varet nga . . .

Mësimdhënie Cilësore në të Gjitha Nivelet

Fëmijëria e Hershme

- Krijimi i Qendrave Rajonale për fëmijët parashkollorë
 - Të bëhet vlerësimi mbi zhvillimin e fëmijës për të përcaktuar nivelet e nevojshme të zhvillimit mendor, social dhe emocional, zhvillimin e të folurit dhe atë gjuhësor, zhvillimin psikomotor gjatë tre viteve të para;
 - Të bëhet identifikimi i fëmijëve me zhvillim mendor të vonë dhe mbështetja e tyre dhe familjeve të tyre, përfshirë dhënien prioritet të qendrave rajonale të fëmijëve të mitur;
 - Çdo muaj, familjet të fëmijëve me zhvillim mendor të vonshëm të pajisen me paketën mësimore të detyrave;

- Të kryhen vizita në familje e nxënësve të kopshtit për të realizuar trainime speciale në ndërhyrjet e sukseshme, që mund të bëhen në shtëpi.
- Të ofrohet asistencë gjuhësore për nxënësit ELL që mësojnë Anglisht, për parashkollorët dhe familjet e tyre.
- Ndërtimi i qendrave kujdesi fëmijësh/çerdheve në shkolla të mesme të caktuara, për të ndihmuar fëmijët e nxënësve të shkollës dhe punonjësve të drejtorisë arsimore.
- Zhvillojmë dhe shpërndajmë tek drejtuesit e qendrave parashkollore, të çerdheve dhe atyre në nevojë programe me standarte të përbashkëta për fillimin me sukses të klasës së kopshtit.

Shkollat Fillore

- Leximi
 - Të sigurojmë, që të gjithë nxënësit e fillores të jenë në nivelin i/e aftë në lexim në klasën e tretë.
 - Të përdorim mjete të ndryshme vlerësimi për identifikimin e nxënësve, që kanë nevoja për ndërhyrje të veçantë në lexim.
 - T'u ofrojmë nxënësve me rezultate nën 40 përqindshin, mundësi pjesëmarrje në leksionet e përditshme gjysëm orëshe për 12-20 javë prej mësuesve të kualifikuar në lexim
 - Të përmirësojmë rjedhshmërinë në lexim të nxënësve ELL dhe të nxënësve të fillores me mungesa gjuhësore ,duke përdorur modele vizuale dhe gojore për të njohur fjalët më të përdorshme në mënyrë, që t'i njohin ato më shpejt gjatë leximit
- Të garantojmë, që çdo nxënës i fillores të marrë mësim arti dhe muzike.
- Të sigurojmë, që ombdusmenët e prindërve, këshilltarët e nxënësve, dhe koordinatorët e shërbimeve sociale, të punojnë për identifikimin e nxënësve dhe familjeve në krizë për shërbime të hershme dhe të gjithanshme .
- Krijimi i klasave për nxënësit e talentuar në të gjitha shkollat fillore
- Ulja e numrit të nxënësve në klasë.
 - Nxënësit e kopshtit-20 nxënës në klasë
 - Nga klasa e parë deri në të tretën -22 nxënës në klasë

Shkollat 8-vjeçare

- Krijimi i mjediseve mësimore të strukturuar dhe individuale, duke përdorur një shumëllojshmëri strukturash mësimdhënie për të përmbushur nevojat e gjithashme të nxënësve.

- Grupimi i stafit dhe nxënësve në komunitete të vogla (d.m.th. ekipe bazë lagje, apo akademi të vogla) për përmirësimin e metodave të mësimdhënies në arritjen e rezultateve të larta.
- Sigurimi i kohës së planifikimit të përbashkët për ekipet e mësuesve.
- Shoqërimi i nxënësve nga mësuesit e Matematikës dhe Anglishtes, në mënyrë që mësuesit të qëndrojnë me nxënësit e tyre më shumë se një vit për të siguruar vazhdimësi dhe njohje të detajuar të nxënësve.
- Sigurimi i raportit një mësues këshilltar për çdo 150 nxënës.
- Sigurimi për çdo nxënës i mentorëve, këshilltarëve, ose i një të rrituri që të qëndrojë në kontakt me këtë nxënës gjatë gjithë shkollës 8-vjeçare.
- Planifikimi i ditës mësimore për mbështetjen akademike, përzgjedhëse dhe eksplorimin e të ardhmes së nxënësve. Koha shtesë, do të shërbejë për eksplorimin dhe pasurimin e mëtejshëm të gjashtë lëndëve bazë, që janë lexim, matematikë, shkencë, sociologji, edukim fizik, dhe art ose muzikë.
- Krijimi i mjediseve mësimore të strukturuar, ku nxënësit mësojnë veprimtaritë jetësore.
 - Bashkërendimi i procedurave efektive dhe veprimeve rutinë për drejtimin efektiv të mësimdhënies në çdo klasë.
 - Lehtësimi i përvetësimit të mësimin nëpërmjet modeleve dhe studimeve të gatëshme për nxënësit.

Shkollat e Mesme

- Hapja e tre shkollave të mesme Teknike dhe Profesionale në bashkëpunim me unionin e komunitetit të tregëtarëve, institucioneve të shëndetit dhe industrinë bioteknike.
- Hapje e një shkolle të mesme të vogël për përgatitjen e mësuesve të ardhshëm të Filadelfias.
- Pajisja me një mësues këshilltar në çdo nivel klase/viti, për çdo 200 nxënës, i cili do të qëndrojë me secilën klasë për katër vjet.
- Individualizimi i procesit mësimor duke kultivuar tek nxënësit ndjenjën e sigurisë për përvetësimin e mësimin.
 - Krijimi i planeve individuale lidhur me diplomimin për çdo nxënës të klasës 9-të duke përfshirë vlerësimin profesional.
 - Caktimi i një të rrituri për çdo nxënës për të ndihmuar atë gjatë gjithë experiences së tij/saj shkollore.
 - Krijimi i klasave me mësues këshilltar/kujdestari në të gjitha shkollat e mesme.

- Krijimi i mundësisë së shoqërimit të klasave të 9-ta dhe të 10-ta për lëndët Anglisht dhe Matematikë.
- Zhvillimi i afateve fleksible dhe modeleve grup nxënësish/Develop flexible scheduling and student grouping patterns.
 - Krijimi i afateve, që do të lejojnë hapësira për kurse ndërhyrje , rikuperim të krediteve, ose pasurim të tyre.
 - Planifikimi i shtatë orëve mësimore në ditë (tetë orë në raste rikuperimi).
 - Planifikimi në mënyrë që nxënësit të punojnë në grupe me një ekip mësuesish.
 - Krijimi i vlerësimeve dhe përshpejtimit të marrjes së krediteve mbi baza standarte në mënyrë që nxënësit të mund të ecin me hapin e tyre gjatë viteve të shkollës së mesme.
 - Përdorimi i informacionit të internetit, që krijon mundësira më fleksibile për mësimin.
- Ndërtimi i Qëndrave të Suksesit drejt Kolegjit në çdo shkollë të mesme, të cilat do të krijojnë mundësi për nxënësit për t'u përgatitur, zgjedhur dhe aplikuar për në kolegji.
- Ngritja e numrit të oportuniteteve për nxënësit, që të marrin pjesë dhe të dalin me sukses në kurset me regjistrim të dyfishtë dhe njohjen e hershme me eksperiencën e kolegjit.
- Mbështetja akademike për përgatitjen e nxënësve për testet ACT dhe SAT.
 - Përdorimi i paketave me testet përgatitore SAT/ACT.
 - Ofrimi i testeve përgatitore SAT/ACT gjatë gjithë vitit shkollor.

Kurikula Mësimore

- Ripërpunimi i kurikulës mësimore nga Para-K-12 për përmirësimin e praktikave mësimore në të gjitha fushat e përbajtjes (Para-K, K-8, Shkollat e Mesme) dhe sigurimi i një mësimdhënie cilësore.
 - Futja në kurikulën mësimore të praktikave mësimore, si psh. mësimi në grupe, mësimdhënia mbi baza kërkimore, grafikëve, hartave memece, mësimëve mbi bazë projekti, simulimeve, mësimëve praktike dhe teknologjise së avancuar.
- Përfshirja e kërkesave të shekullit të 21 në të gjitha aspektet e kurrikulës mësimore:
 - Përgjegjësi dhe adaptim.
 - Aftësi komunikuese.
 - Krijimtari dhe kuriozitet intelektual.
 - Mendim kritik dhe me sistem.

- Aftësi në informim letrar dhe media.
- Aftësi ndërpersonale dhe bashkëpunuese.
- Arsyetim dhe zgjidhje problem.
- Përgjegjësi sociale.

Programet dhe Shërbimet e Specializuara

Nxënësit që Mësojnë Anglisht

- Krijimi i një kurikule mësimore të qartë (nga Para-K deri në klasë 12) plotësuar me vlerësimet e standardizuara dhe niveleve për matjen e njohurive dhe kufirin kohor të daljes nga program.
- Zgjedhja dhe implementimi i një strukture me bazë kërkimore për tranzicionin dygjuhësor, dhe programet dygjuhësore.
 - Pajisja e nxënësve me një program të tranzicionit dygjuhësor, në të cilën gjuha amtare mësohet deri sa aftësitë e nxënësit në Anglisht bëhen të mjaftueshme, që lejojnë pjesëmarrjen e tij/saj me sukses në klasat vetëm në Anglisht.
 - Sigurimi i programeve dygjuhësore për nxënësit me gjuhë amëtare tjetër nga Anglishtja.
 - Sigurimi i programeve dygjuhësore në çdo rajon, që ofron shumëllojshmëri në mësimdhënie si p.sh. mësimdhënie në të dyja gjuhët në lëndën arti gjuhësor, mësimdhënie në aftësitë letrare (të leximit) si fonetikë dhe të folurit e rjedhshëm, së bashku me mundësinë e leximit të letërsisë në të dyja gjuhët, si dhe kohë të mjaftueshme për bashkëveprimin midis nxënësve (si nëpërmjet mësimin me grupe), duke u dhënë mundësi nxënësve të praktikojnë aftësitë e tyre të reja gjuhësore me shokët e klasës.
- Hapja e tre Qendrave Rajonale për të porsaardhurit, ku nxënësit e porsaardhur mund të marrin mbështetje intensive për periudhën tranzicionale në mësim dhe adaptimin kulturor për 6-12 muaj.
- Identifikimi dhe përcaktimi gjeografik i shkollave, që mund të shërbejnë si vende për mësimin e Anglishtes nga familjet, që e kanë Anglishten si gjuhë të dytë.
 - Mundësi kualifikimi profesional për të gjithë mësuesit, në mënyrë, që ata të jenë të aftë për mësimdhënie e nxënësve ELL dhe njëkohësisht shanse për mësuesit e rregullt, që të bëhen mësues të certifikuar për t'u dhënë mësim nxënësit ELL.

- Përdorimi i metodave të larmishme të mësimdhënies, në mënyrë që mësuesi të mund të bëjë lidhjen e atyre që mëson nxënësi me fjalët, numrat, fotografitë muzikën ose eksperiencën e ndërsjellë.
 - Të ofrojmë metoda të ndryshme të mësimdhënies, që lejojnë nxënësin që të zhvillojnë diskutime në klasë ndërsa lexojnë dhe shkruajnë
 - Të ofrojmë metoda të frytshme në art gjuhësor, matematikë, shkencë dhe studime shoqërore, përmes kalimit të nxënësve me mangësi në anglisht drejt arritjeve më të larta akademike, ndërsa përvetësojnë gjuhën angleze.
 - Përdorimi i teknikave të shumta me nxënësit që mësojnë anglisht, si psh, adaptimi i një teksti, duke u përqëndruar në fjalorin kryesor, lidhja e mësimi të ditës me mësimet e mëparshme, dhe ofrimi i mundësive për ndërlidhje me lëndët e tjera.
- Përfshirja e iniciativave intensive dhe efektive të zhvillimit profesional për trainimin e mësuesve, administratorëve, personelit ndihmës dhe atij rajonal në programe kërkimore dygjuhësore dhe ESOL.
 - Pajisja e mësuesve, administratorëve, personelit mbështetës dhe atij rajonal me aftësitë e nevojshme profesionale për mbështetjen e nxënësve në një mjedis dashamirës dhe të ndjeshëm nga pikëpamja kulturore
 - Pajisja e mësuesve, administratorëve, personelit mbështetës, dhe atij rajonal me një bazament të plotë të përvetësimit gjuhësor, si dhe të përmbajtjes së lëndëve.
 - Pajisja e mësuesve, administratorëve, personelit mbështetës dhe atij rajonal me trainime, se si të realizojnë mësimet model duke përdorur aktivitete praktike, strategji të ndryshme për përvetësimin e fjalorit dhe përdorimin e mjeteve vizuale.

Nxënësit që mësojnë Anglisht të klasave të edukimit special

- Zbatimi i procesit IEP me përpikmëri dhe përdorimi i stimuljeve vjetorë në shkollat që kanë rezultate më të mira në procesin e IEP-së.
- Pajisja me plane mësimore të individualizuara të IEP që përfshijnë standardet shtetërore në kurikulën e arsimit të përgjithshëm, të shoqëruara me rezultate të pritëshme të larta, mësimdhënie të fokusuar dhe rritje të mëtejshme të përmbajtjes të kurikulës.
 - Përfshirja e /modifikimeve në përmbajtjen e lëndëve, duke përcaktuar materialet dhe/ose burimet, që janë në përputhje me standardet shtetërore që përdoren dhe krijimi i prioriteteve për nxënësit si pjesë e të gjithë procesit IEP-së.

- Përdorimi i praktikave mësimore, që mbështesin mësimin e nxënësve të edukimit special
 - Bërja e kurikulës më të kapshme për nxënësit e edukimit special, duke përdorur strategji, si p.sh. tabela grafike dhe mësimi në grup.
 - Mësimi dhe vlerësimi i nxënësve duke përdorur metoda, materiale, dhe mjedise të ndryshme (vizuale, dëgjimore, të prekshme, e të tjera).
 - Përdorimi i kritereve specifike për dokumentimin e mënyrave të ndryshme të të mësuarit të nxënësve dhe përcaktimi i mjeteve më rezultative në procesin e mësimin (d.m.th. vizuale, dëgjimore, të prekshme, e të tjera).
 - Bashkërendimi i aktiviteteve dhe përdorimi i më shumë se një menyre të të mësuarit, kur është e mundëshme.
- Futja e modelit të përfshirjes së nxënësve të edukimit special në klasat e rregullta, nëse është e mundëshme.
 - Pajisja e nxënësve të edukimit special me mësues të edukimit të përgjithshëm dhe atyre të edukimit special, që planifikojnë dhe bëjnë mësim sëbashku (d.m.th modeli co-teaching me dy mësues në klasë).
 - Ofrimi i eksperiencave bashkëpunuese të mësimin për nxënësit e edukimit special përmes modelit co-teaching.
- Ofrimi për të gjithë mësuesit i kualifikimeve profesionale në vazhdim, që të mbështesin përfshirjen e gjithë nxënësve me nevoja special.
 - Ofrimi për personelin e shkollës të trainimeve se si të analizojnë eksperiencat e ndryshme mësimore për të përcaktuar përdorimin më efikas të metodave mësimore.
 - Ofrimi për personelin e shkollës të trainimeve lidhur me metodat e ndryshme të mësimdhënies.
 - Ofrimi për personelin e shkollës të trainimeve, që kanë të bëjnë me modelin co-teaching dhe anët pozitive të mësimin në grup, për përmiresimin e të të mësuarit nga ana e nxënësve
- Ri-njohja e Koordinatorëve Rajonalë të tranzicionit, të cilët do të koordinojnë burimet ekzistuese për dhënien e informacionit, trainimit dhe dhënien e ndihmës teknike për familjet dhe nxënësit, ndërsa ata kalojnë nga një klasë në tjetrën dhe gjatë tranzicionit të tyre në punë ose më pas shkollës së mesme.
- Ri-njohja e ekipit të burimit të formimit të sjelljes, i cili do të ofrojë teknika për t'u përballur me probleme të vështira në sjellje në situatat reale, veçanërisht në familje, shkollë, dhe mjedise, të programeve sociale, për të gjithë mësuesit, prindërit,

instruktorëve, punonjësit socialë, ose çdonjërin që është përgjegjës për edukimin dhe mbikëqyrjen e nxënësve.

Nxënësit e Talentuar dhe me Dhunti të veçanta

- Zgjerimi i programeve për nxënësit e talentuar në shkollat fillore
- Rritja e oportuniteteve për nxënësit, që të marrin pjesë dhe të jenë të suksesshëm në kurset e Nderit dhe ato të Avancuara, duke ofruar kurse të tilla në të gjitha shkollat e mesme.

Programe dhe Mbështetje të Gjithanshme për të Gjithë Nxënësit

Udhëheqje dhe Këshillim

- Ofrimi i shërbimeve me cilësi të larta akademike këshillimore, të shëndetit mendor dhe programeve mbështetëse, që përfshijnë partnerë si agjensitë e komunitetit, biznesin/industrinë dhe kolegjet/universitetet.
- Sigurimi i shërbimeve këshillimore akademike, që ndihmojnë nxënësin dhe prindërit e tyre të njihen me kurrikula e ndryshme dhe të planifikojnë një program studimi për të vazhduar studimet e mëtejshme pas shkollës së mesme.
- Mundësimi i shërbimeve këshillimore lidhur me karrierën, punën, dhe mësimin të zanateve.
- Sigurimi i shërbimeve këshillimore sociale dhe individuale për të ndihmuar nxënësit në zgjidhjen e konflikteve, percaktimin e objektivave individuale, dhe për të kuptuar vetveten dhe nevojat e të tjerëve.

Atletika

- Të ofrojmë programe të brendëshme (të shkollës) në të gjitha shkollat 8-vjeçare dhe të mesme.
- Të krijojmë programe atletike që fokusohen në përgatitjen, mbajtjen e një qëndrimi pozitiv, dhe ndërtimin e standardeve të larta lidhur me sjelljen.
- T'u kultivojmë nxënësve punën në ekip, korrektësinë e natyrën sportive.

Udhëheqja e Nxënësve

- Të zhvillojmë mundësi drejtimi për nxënësit në të gjitha shkollat 8-vjeçare dhe të mesme
- Të sigurojmë pjesëmarrje në të gjitha shkollat në organizimet e qeverisjes së nxënësve

- Të krijojmë mundësi meditimi për nxënësit, projekte mësimore praktike, dhe mundësi në bazë shkolle gjatë gjithë vitit shkollor

Riparimi dhe Pasurimi

- Të sigurojmë oportunitete “që arrihen lehtë” për përmirësimin e arritjeve gjatë verës, pas shkolle, dhe të Shtunave.
 - Të krijojmë qendra rajonale të talenteve, në partneritet me organizata të arteve të bukura, në komunitet.
 - Të bashkëpunojmë me organizatat e komunitetit, bizneset/industrinë, dhe kolegjet/universitetet, për të siguruar aktivitete të pasura jashtëshkollore, për familjet.
 - Të kërkojmë mbështetje nga organizata dhe fondacione filantropike, për të siguruar instrumente dhe pajisje muzikore, për nxënësit në nevojë.
- T’u japim nxënësve mundësi për të fituar experience në muzikë, arte vizuale, vallëzim dhe dramë si pjesë përbërëse e edukimit të tyre.
 - Të mbështesim dhe kërkojmë standarde të larta për nxënësit dhe t’injohim ata me ekzemplarët më cilësor të arteve të qytetit dhe të vendit.
 - Të propangadojmë punët e nxënësit.
- Të sigurojmë mbështetje akademike para dhe pas shkolle, nëpërmjet komunitetit dhe organizatave të tjera, të cilat adresojnë nevoja specifike akademike të nxënësve të vështirë dhe përdorimi i vlerësimeve të testeve, për rritjen e përgjegjësisë së tyre.
 - Monitorimi i rregullt i nxënësve dhe përshtatja e ndërhyrjeve, sipas kërkesave të tyre individuale.
 - Të krijojmë sesione tutorimi të bazuara në nevojat specifike, sipas vlerësimeve të testeve benchmark.

Mundësi të programeve ekstra-kurikulare

- Të krijojmë programe dhe aktivitete ekstra-kurikulare dhe plotësuese, që përputhen me misionin e shkollës.
 - Të sigurojmë për nxënësit mundësi për pjesëmarrje në programe, që mbështesin fushat kryesore të përmbajtjes, interesat e tyre ose shpirtin praktik. (dmth klubet e matematikës, spanjishtes e tjera)
 - T’u japim nxënësve mundësi, për të zgjeruar aftësitë e tyre interpretuese (psh. në bandën, korin e shkollës, e tjera).

Praktika Mësimore

- Të sigurojmë mundësi për punë praktike për të gjithë nxënësit e shkollës së mesme
- Njohja e nxënësve duke filluar nga shkolla fillore dhe në vazhdimësi gjatë gjithë shkollës 8-vjeçare dhe të mesme, me praktikën mësimore, llojet e zanateve, dhe aktivitetet eksploruese të profesioneve të ndryshme.
- Të krijojmë akademitë e profesioneve të ndryshme në të gjitha shkollat e mesme të modelit të përgjithshëm.

Programet Ri-përfshirëse

- Të ofrojmë një larmi opsionesh shkollore me baza kërkimore, për rininë, që nuk është në shkollë.
 - Të dyfishojmë numrin e nxënësve, të cilët mund të regjistrohen në Shkollat me program të përshtetshëm dhe të rrisim çdo semester numrin e tyre, deri sa çdo nxënës që është i interesuar ose ka nevojë për këtë opsion, të mund të regjistrohet me kohë të plotë në programin që ai ose ajo ka bërë zgjedhjen.
 - Të sigurojmë që përmbajtja e programeve në shkollat me drejtim të përgjithshëm, të përfshijë opsione për të gjithë nxënësit, sipas niveleve, aftësive dhe nevojave.
 - Të hapim të paktën një shkollë të re për rininë joshkolllore në çdo rajon gjeografik të qytetit.
 - Të hapim Qendra ri-angazhimi satelitore, në zonat ku niveli i nxënësve, që braktisin shkollën është mbi 40%.
 - Të hapim katër Qendra Ri-përfshirëse me partnerë të komunitetit dhe Departamentin e Shërbimeve Humane mbarëqytetare.
 - Të hapim Qendra Ri-përfshirëse në komunitete të tjera që kanë më shumë nevojë (p.sh., Qëndror Lindor/Lindor, me kod postal 19140, 19134, 19124; zonën veriore të Filadelfias me kod postal 19132, 19121; dhe Jug Perëndimore 19143; Perëndimore 19139) çdo vit bazuar në nevojat e nxënësve dhe kërkesën e komunitetit.
- Të krijojmë Institutin e Zhvillimit të Talenteve për shkollat që punojnë me rininë jo shkollore, për të ndihmuar në trainimin e administratorëve dhe mësuesve në projektimin e programeve cilësore për të plotësuar nevojat e këtyre nxënësve.
- Të zbatojmë një sistem të deftesave për të ndjekur dhe raportuar mbi përparimin e rinisë joshkolllore.
- Ri-përfshirjen e rinisë jo shkollore.

- Punësimi dhe trenimi i Ekipeve, që funksionojnë në komunitetet lokale për identifikimin e rinisë joshkollore dhe rilidhjen e tyre me shkollën përmes Qendrave të ri-përfshirjes (p.sh., Modeli i Këshillit Privat të Bostonit).
- Të krijojmë Ekipe për lidhjen me të Rinjtë në mbarë qytetin, ku nxënësit mund të fitojnë një pagesë gjatë praktikës dhe të marrin kredite fakultative gjatë gjithë vitit.
 - Punësimi i një Drejtori me kohë të plotë, që do të drejtojë Qendren e Ri-Përfshirjes së rinisë për mbikëqyrjen e programeve të mësipërme.
 - Të ndihmojmë familjet dhe komunitetet të ri-angazhojnë rininë joshkollore
 - Të edukojmë prindërit e rinisë joshkollore mbi programet ri-angazhuese dhe opsioneve për përfundimin e shkollës.
 - Të ndërtojmë partneritete me familjet dhe grupet e komunitetit për të mbështetur ri-angazhimin e rinisë.
 - Të krijojmë partneritet me Qytetin dhe organizatat me bazë komuniteti për të kryer në mënyrë aktive identifikimin dhe rilidhjen e rinisë me shkollën.
 - Të rrisim bashkëpunimin me agjensitë e qytetit për të siguruar programe dhe qendra aktiviteti.
 - Të bashkëpunojmë me Departamentin e Shërbimeve Humane të qytetit, për të përcaktuar burimet në ndihmë të ri-angazhimit të rinisë.
 - Të sigurojmë një hartë shërbimi të të gjitha burimeve të financuara nga qyteti në shkollat dhe komunitetet shkollore, për të riadresuar shërbime drejt këtij ri-angazhimi.
 - Punësimi dhe shpërndarja e personelit DHS për të shërbyer si manexherë për këtë qëllim në qendrat e reja satelitore të ri-përfshirjes.
 - Riadresimi i resurseve të qytetit për shkollat.

Edukimi Shëndetësor

- Krijimi i një programi mbi të ushqyerin e shëndetshëm, për nxënësit e shkollës fillore.
 - Të përdorim një mjet vlerësimi mbi të ushqyerin e shëndetshëm, për të krijuar një plan veprimi për shkollën.
 - Të krijojmë një program promovimi mbi ushqyerjen e shëndetshme për shkollat fillore, që mbështetet në mësimin e fëmijëve të vegjël nga më të rriturit (“shokë të shëndetshëm”).

- Të zbatojme nje program edukimi shëndetësor dhe fizik te gjithanshëm dhe të mirëbalancuar, që do të kontribuojë në zhvillimin emocional, social, mendor dhe fizik te nxënësve.
 - Të krijojmë dhe zbatojmë një sistem të politikave, procedurave, dhe aktiviteteve, per mbrojtjen e shëndetit dhe mirëqenies të nxënësve dhe personelit, duke përfshirë edukimin shëndetësor, një mjedis shkollor të shëndetshëm, dhe sherbim shëndetësor.
 - Të zhvillojmë një plan të rekomanduar jetësor të shëndetshëm.

Sistem sinjalizimi, që paralajmëron herët rezultate jo në nivelin e duhur

- Të zhvillojmë një sistem sinjalizimi, që paralajmëron herët, për të gjithë nxënësit e shkollës fillore, 8-vjecare dhe te mesme. Sistemi do të përfshijë treguesit e mëposhtem: frekuentimin, arritjet akademike në matematikë dhe Lexim/Anglisht, dhe sjelljen e nxënësit.
 - Të krijojmë një platformë treguese paralajmëruese, për të gjitha ekipet e menaxhimit në shkollat fillore, 8-vjecare dhe të mesme.
 - Të treinojmë Superintendentët (drejtorët) Rajonalë, drejtorët e nëndrejtorët e shkollave dhe anëtarët e ekipeve të menaxhimit si të përdorin këtë sistem.
 - Të japim një raport mujor Superintendentëve të Rajoneve për të matur progresin drejt eliminimit të barrierave për nxënësit.
- Të përdorim planifikimin e sistemit sinjalizues paralajmërues të hershëm në mbarë shkollat, grupet kryesore, dhe nxënësit e veçuar.
 - Të krijojmë një ekip menaxhimi, duke përdorur treguesit e sinjalizimit të hershëm në çdo shkollë.
 - Të përdorim sistemin në Planin e Shkollave në Përmirësim.
 - Mësuesit të përdorin këtë sistem në identifikimin e nxënësve të klasave të tyre dhe pastaj të aplikojnë informacionin për të ndihmuar nxënësit të plotësojnë mungesat e tyre në mësim dhe të tjera nevoja.
 - Të projektojmë një plan ndërhyrjesh dhe të mbështesim nxënësit që manifestojnë sjellje specifike dhe të rrezikshme.
- Të përdorim sistemin sinjalizues të hershëm për monitorimin dhe vlerësimin e suksesit të shkollës
 - Të rishikojmë progresin e shkollës drejt uljes së numrit të nxënësve që kanë rrezik të manifestojnë sjellje jo të duhur të paktën çdo muaj, si edhe burimet shtesë që jepen për të ndihmuar nxënësit që nuk bëjnë progres.

- Të caktojmë mbledhje dymujore me Superintendentët rajonalë dhe drejtorët e shkollave, për rishikimin e progresit mbi të dhënat e shkollave të tyre.
- Të vlerësojmë Drejtorët e shkollave dhe Superintendentët rajonalë bazuar në uljen e numrit të nxënësve që manifestojnë sjellje të rrezikshme.
- Të informojmë prindërit dhe nxënësit mbi këta tregues paralajmërues, opinionin e tyre për progresin akademik, dhe si të krijojmë dhe mbështesim një plan ndërhyrjeje.
 - Të krijojmë një fushatë marketingu mbarëqytetar me Qytetin e Filadelfias për edukimin e prindërve rreth katër treguesve paralajmërues dhe si të kërkojnë ndihmë për fëmijët e tyre.
 - Të mbajmë forume me prindërit për të njohur prindërit mbi treguesit paralajmërues dhe strategjitë e ndryshme për parandalimin e fëmijëve të tyre, që të mos lënë shkollën.
 - Të japim njoftime të përcaktuara qartë për prindërit me një raport tremujor, nëse fëmija e tyre manifeston një apo me shumë sjellje të rrezikshme, duke dhënë edhe një numër telefoni ku ata mund të marrin dhe të lënë takim me personelin shkollës për të marrë ndihmë për fëmijën e tyre.
 - Të njohim prindërit dhe familjet e tyre mbi këta tregues paralajmërues në të gjitha takimet apo aktivitetet me prindër gjatë vitit shkollor.
- Të bashkërendojmë punën mbi Frekuentimin dhe Largesat nga shkolla për të gjithë të rinjtë që janë në rrezik të lënë shkollën.
 - Të realizojmë një proces rishikimi të thellë dhe në vazhdimësi me të gjithë grupet e interesuara për të bashkërenduar burimet e Drejtorisë dhe Qytetit për të rritur frekuentimin e rregullt dhe ulur numrin e largesave nga orët e mësimi.
 - Të zbatojmë një fushatë mbarëqytetare në shtyp mbi rëndësinë e ndjekjes së shkollës rregullisht.
 - Të zgjerojmë Gjykatat e të Rinjve në çdo shkollë për t'u takuar me ata nxënës që lënë orët e mësimi dhe/ose kanë më shumë se dy mungesa pa arsye, për të përpunuar një plan mbështetjeje.
 - Të krijojmë një ekip, që do merret me frekuentimin në çdo shkollë të përbërë nga personeli i shkollës (p.sh., menaxheri i mjedisit në shkollë, dekani i nxënësve, ombudsmeni i prindërve, koordinatori i shërbimeve sociale, dhe këshilltarët e nxënësit) dhe të caktojmë një drejtues ekipi, si person i vetëm kontakti për problemet që kanë të bëjnë me frekuentimin dhe largesat nga mësimi.

Shërbime për nxënësit gjatë tranzicionit të tyre

Nga Para-shkollor deri në Kopsht, Shkollat fillore deri në 8-vjeçare, 8-vjeçare deri në të Mesme

- Të forcojmë programet e Verës (*Summer Bridge Programs*)
 - Nga klasat parashkollor deri në Kopsht: t'u japim mundësi gjithë nxënësve, që do fillojnë kopshtin të kalojnë një eksperiencë një javore në verë, para se të hyjnë në kopsht.
 - Nga klasat e 5-të deri në 6-tën: orientim tre ditor
 - Nga klasat e 8-ta deri të 9-tën: orientim tre ditor
 - Të zhvillojmë dhe shpërndajmë nxënësve dhe prindërve çfarë pritet nga fëmijët e tyre në mësimet dhe sjellje.

Edukimi alternativ

- Të bëjmë një plan gjashtëmuor për të gjithë nxënësit, që dalin nga shkolla Alternative.
- Të caktojmë një këshilltar drejtues për nxënësit e kthyer nga shkolla alternative.
- Të vazhdoen shërbimet me staf që ndjek dhe monitoron sjelljen (*wrap-around*) për të gjithë nxënësit deri në gjashtë muaj.

Mjedis Mesimor i Sigurtë

Klimë Pozitive në Shkollë

- Të zbatojmë politikën e një Kulture të Vetme në Shkollë, një përpjekje për të përfshirë të gjithë të rriturit në shkolla të marrin në dorë drejtimin e mjedisit mesimor, me përpikëri, në të gjitha shkollat, për sigurimin e një klime pozitive për mësim.
- Të përdorim standardet mbi sigurinë dhe klimën në shkollë për monitorimin dhe vlerësimin e mjedisit shkollor.
- Të ndërtojmë tregues të një sigurie dhe klime shkollor me cilësi të lartë.
- Të treinojmë personelin e drejtorisë qendrore për të kryer kontrolle mbi sigurinë, të bëjë audite, si edhe t'u japë shkollave vlerësimet mbas kontrolleve dhe të mbështesë këto vlerësime mbi bazen e rezultateve.
- Të përfshijmë incidentet e raportuara si një tregues në deftesat shkollor.
- Të sigurojmë ndërtesën shkollorë në mënyrë që, asetet dhe inventari shkollor të jetë i mbrojtur.

- Të përdorim standardet mbi sigurinë dhe klimën shkollore për të bërë vlerësimin e personelit dhe të kryejmë kualifikim profesional.
- Të përdorim Ekipin e Mbështetjes së Nxënësit dhe Ekipin e Sigurisë së Klimës në shkollë të rishikojnë të dhënat herë pas here, për të vlerësuar ecurinë e punëve.
- Të mbledhim dhe analizojmë të dhëna (duke përdorur SARA) në standardet mbi sigurinë.
- T'u japim mundësi ekipeve në bazë shkollë të rishikojnë të dhënat dhe të identifikojnë nxënësit me probleme në sjellje dhe të zhvillojnë plane për të plotësuar nevojat e nxënësve
- Futja gradualisht e programit të Përkrahjes së Sjelljes Pozitive (PBS), si një iniciativë që do të konturojë qartë sjelljet e pritëshme mbarëshkollore nga nxënësit, si edhe stafi mbështetës, për të siguruar që shkollat janë konsekuente në përpjekjet e tyre gjatë gjithë periudhës pesë-vjeçare.
- Të punësojmë kordinator PBS të treinar, për të ndihmuar shkollat të zhvillojnë, mësojnë, dhe përforcojnë normat positive mbarëshkollore
- Të rekrutojmë, punësojmë, dhe treinojmë një drejtues ekipi mbi klimën/sigurinë në shkollë, i cili do të shërbejë si ekspert në lidhjen e praktikave mësimore, të sjelljes dhe klimës shkollore me ato të parandalimit në rast incidentesh.
- Të zbatojmë Procesin e Ndhmës së Gjithanshme të Nxënësit (CSAP), një iniciativë që krijon mundësi që nxënësit në shkolla të diskutojnë në forume lidhur me progresin e tyre, për t'i ndihmuar ata të arrijnë sukses
- Të zbatojmë modelin Ndërmjetës mes palëve (*Peer Mediation*) në të gjitha shkollat 8-vjeçare dhe ato të mesme.

Sjelljet e Pritëshme

- Futja e Përkrahjes të Sjelljes Pozitive për të arritur në një konsensus mbarëshkollor mbi rregullat e shkollës dhe çfarë pritët nga nxënësit, bazuar në standardet mbi sigurinë dhe klimën shkollore.
- Të komunikojmë këto standarde tek nxënësit në mënyrë të qartë dhe konsekuente.
- Të organizojmë anketa dhe të bëjmë rishikim të të dhënave periodikisht, që do të identifikojnë dhe kontrollojnë sjelljet e mira, si edhe pengesat drejt një përpjekje për një klimë shkollore në përmirësim.

Mbështetjet, Shpërblimet dhe Pasojat

- Të qartësojmë për personelin e shkollës, nxënësit dhe prindërit mbështetje, shpërblime dhe pasoja të qarta.

- Të ri-vendosim pezullimin nga mësimi brënda shkollës për të gjithë nxënësit në klasat 6-12, pezullim nga shkolla deri në pesë ditë ose më pak.
- Të zbatojmë dhe monitorojmë me kujdes një sistem ku nxënësit e dhunshëm dhe që prishin mësimin të jenë në kontrollin e shkollës dhe/ose të bëhen ndërhyrjet e duhura për përmirësimin e sjelljes në bazë shkolle.
- Të vemë në funksion modelin PBS për të drejtuar burimet dhe vemendjen tone tek nxënësit më të dhunshëm dhe me problem.

Përfshirja e Prindërve dhe Familjes

Komunikim i qartë, në vazhdimësi dhe i përshtatshëm

- Të pajisim të gjithë prindërit dhe familjet, veçanërisht ata që historikisht nuk janë ndihmuar si psh ata që kanë diferenca gjuhësore dhe kulturore, me informacion të qartë dhe relevant mbi progresin akademik dhe social të fëmijëve të tyre.
 - Të organizojmë anketime të vazhdueshme me prindërit dhe familjet për të përcaktuar nevojat, si edhe programet që janë me interes për ta.
 - Të ngrejmë në një shkallë më të lartë përdorimin e Qendrës së Familjes, Qendrës Walk-in, websaitit të Rrjetit shkollor (*School Network*) dhe qendrave të tjera informuese, për të përmirësuar komunikimin mes shkollës dhe familjes.
 - Të eliminojmë pengesat të regjistrimit të nxënësve të familjeve emigrante.
- Të zhvillojmë bashkërisht një lidhje mes Prindërve dhe Drejtorisë Arsimore, që përcakton ç'ka pritet nga të dy palët.
 - Të mbledhim dhe shpërndajmë praktikatat më të mira brënda dhe jashtë për të angazhuar prindërit dhe familjet.
 - Të ndërtojmë një Komitet Këshillimor të Familjes, për të informuar mbi politikatat, programet, dhe praktikatat që do të kenë efekt tek prindërit dhe familjet.
 - Të angazhojmë prindërit të flasin mbi politikatat e shkollës dhe atë ç'ka pritet nga ata.

Shërbim Qytetar i Përsosur

- T'u japim mundësi prindërve dhe familjeve të takohen me personelin e shkollës, si mësuesit dhe drejtorët.
 - Të përdorim personelin ndihmës të nxënësve në mënyrë të kordinuar që të shërbejnë si pike kryesore kontakti për prindërit dhe familjet
 - Të zbatojmë dhe monitorojmë programet e angazhimit shkollë-familje.

- Të kryejmë kualifikim profesional me tematikë mbi mënyrën e shërbimit për të gjithë personelin, që ka lidhje të drejtëpërdrejtë dhe punon me prindërit dhe familjet.
- Të kryejmë kualifikime profesionale për Asistentët Këshilltar dygjuhësh dhe Ombudsmenët e prindërve, për të adresuar me efektivitet nevojat e ndryshme të familjeve.
- Të përfshijmë prindërit dhe familjet në të gjitha vlerësimet mbi arritjet e nxënësve.
- Të punësojmë një Ombudsmen për prindërit në çdo shkollë.

Fuqizim përmes Edukimit

- Shtirirja e programit *“Parent University”*, lidhja e prindërve me universitetet, për përmirësimin e aftësive të nevojshme për një trajtim më të mirë të problemeve të fëmijëve të tyre.
 - Të ndihmojnë për të përmirësuar mirëqënien ekonomike, sociale, emocionale dhe intelektuale të prindërve dhe familjeve.
 - Të përfshijmë prindërit në zhvillimin e kurikulës mësimore.
 - Të vendosim lidhje me këtë program për angazhimin e prindërve dhe familjeve të cilët tradicionalisht janë lënë pas dore dhe/ose izoluar gjeografikisht.
 - Të krijojmë partneritete me organizatat e komunitetit për të përçuar kurikulën mësimore.

Respekt ndaj Kulturave dhe Gjuhëve të tjera

- Të japim mbështetje të diferencuar për të gjithë prindërit dhe familjet, duke përfshirë familjet shumëgjuhësh, nëpërmjet Qendrës Informative të Prindërve dhe Komunitetit me qendër në çdo rajon.
 - Të bashkëpunojmë me organizatat e komunitetit për të zbatuar iniciativa me objektivitet për familjet multilingual dhe ato me ngjyrë.
 - Të zhvillojmë mbështetje të diferencuar për prindërit dhe familjet, komunikime dhe seminare.
 - Të rritim personelin shumëgjuhësh për të realizuar lidhjet dhe mbështetjen me këta prindër dhe familjet e tyre.

Partneritete Strategjike

Fondacione dhe Institucione Filantropike

- Të krijojmë një Zyrë të Përparimit Institucional për Zhvillimin e Fondeve nga bizneset dhe burimeve të tjera, që do të t'i japin shtytje dhe mbështesin punën me nxënësit, shkollat dhe familjet.

Agjensitë e Qytetit, Shtetërore dhe ato Federale

- Të krijojmë partneritet me Departamentin e Shërbimeve Humane të Qytetit për të siguruar shërbim me punonjës social për nxënësit dhe familjet në shkolla.
- Të vendosim dhe mbajmë lidhje me qeverinë lokale dhe shtetërore, që mbështesin axhendën arsimore të Drejtorisë dhe planin e saj strategjik

Bizneset

- Të krijojmë një listë me opsione partneriteti për bizneset
- Të njohim nxënësit me profesionet e ndryshme duke filluar që nga shkolla fillore dhe në vazhdim përmes shkollës 8-vjeçare e të mesme, me fokus mbi praktikën mësimore, mësimin të zanateve, dhe eksplorimit të profesioneve.
- Të realizojmë seanca takimesh ku të diskutohet rreth punëve, profesioneve dhe zanateve për t'u përgatitur për jetën.
- Të vendosim marrëdhënie shkëmbimi experience ku specialistë të shquar të biznesit të asistojnë drejtorinë arsimore me ekspertiza financiare, operacionale dhe fusha të tjera që të rritin kapacitetin.
- Të iniciojmë programe si "Drejtor shkollë për një Ditë" për të tërhequr partner në shkolla.

Kolegjet dhe Universitetet

- Të rritim partneritetin e shkollave me institucionet e larta të arsimit që përfshijnë të gjithë nxënësit.
- Të punojmë me kolegjet e arsimit për të ndërtuar partneritete krijuese, që përgatisin dhe treinojnë mësues, të cilët janë të gatshëm të punojnë në sistemin shkollor publik urban.

Koalicioni i Komunitetit dhe Ish-studentëve

- Të ndërtojmë një shoqatë të ish-studentëve në mbarë distriktin, që mban opinionin publik të mirëinformuar dhe i angazhon ata në lidhje për mbledhjen e ndihmave, dhe që kontribuon me ekspertiza në interes të nxënësve, shkollave dhe iniciativave.

- Të ndërtojmë një koalicion mbarëqytetar në “mbrotje të fëmijëve” të prindërve dhe grupeve të komunitetit për të përmirësuar jetën e fëmijëve dhe forcuar partneritete në bazë shkolle.
- Të zhvillojmë një sistem të përshtatshëm për të ndjekur informacionin mbi partneritetet e stabilizuara, akordojnë zhvillim, ide/koncepte, dhe rezultate të tjera.

Zgjedhje Cilësore

Përfytyroni...

- Një sistem shkollash ku shkollat më të mira shpërblehen vazhdimisht dhe shkollat e dështuara mbyllen
- Një sistem shkollash ku çdo shkolle drejtohet nga individë pasionantë dhe novator, të cilët vënë gjithmonë fëmijët në plan të parë
- Një sistem shkollash ku çdo individ, organizatë ose kompani dijnë si të operojnë/drejtojnë shkollat, ku nxënësit janë të suksesshëm, të gatshëm të konkurojnë për oportunitete, në mënyrë që të ndryshojnë shkollat e dështura dhe të hapin shkollat që kanë rezultate të larta dhe që plotësojnë nevojat e fëmijëve të Filadelfias

Ofrimi i zgjedhjeve cilësore varet nga . . .

Një Model i Ri i Zgjedhjes së Shkollës

Ne përfytyrojmë tre tipe bazë të modelit të shkollave në përpjekjet tona për të krijuar një sistem shkollash të përsosura.

Shkollat Pararojë

Ne do të shpërblejmë shkollat me rezultate të larta, që përmbushin objektivat vjetore me vetqeverisje dhe që kanë sukses të vazhdueshëm.

- Duke përdorur të dhëna objektive të rezultateve, të identifikojmë shkollat e drejtorisë, shkollat çartër dhe ato me kontratë që tejkalojnë arritjet. Një analizë e tillë do të ndihmojë prindërit të krahasojnë progresin me shkolla të një niveli të drejtorisë.

- Të hyjmë në “marrëveshje autonome” me shkolla që kanë arritje që përcaktojnë objektiva arritjesh vjetore, të cilat duhet të arrihen nga shkolla për të mbetur si shkollë që operon me vetëqeverisje.
- Të treinojmë, japim burime dhe mbështetje shkollave me arritje të larta që të operojnë në mënyrë autonome nga Drejtoria dhe/ose shumëfishojnë punën e tyre me shkolla të tjera të drejtorisë, që historikisht kanë dështuar në përpjekjet e tyre për të ngritur rezultatet e nxënësve.

Shkollat me mbështetje të veçantë

Ne do të realizojmë mbështetje shkollave në vështirësi për t'i përmirësuar dhe të realizojnë objektivat e tyre.

- Të kryejmë ndërhyrje intensive nga drejtoria në shkollat me rezultate të ulta në shumë fusha, duke përfshirë mesimdhënien, shërbimet mbështetëse të nxënësit, operacione të ndryshme, mësues dhe udhëheqje efektive.

Shkolla të Rikonstruktura

Ne do të mbyllim shkollat jo efektive dhe përqafojmë ato drejtime arsimore të reja që kanë dhënë prova për sukses që përfshijnë ristrukturimin e shkollave brenda drejtorisë (in-district charters) dhe partneritetet e jashtëme (shkollat me kontratë dhe partnerët e ndryshuar të drejtorisë). Arritjet e këtyre kontraktorëve do t'i bëjë këta përgjegjës në përmbushjen e objektivave specifike për rritjen e rezultateve të nxënësit.

- Të zhvillojmë objektivat matëse për identifikimin e shkollave që duhet të ndryshojnë partnerët e brëndshëm ose të jashtëm.
- Të kërkojmë dhe të zgjedhim organizata dhe individë të jashtëm të kualifikuar të ndryshojmë shkollat historikisht me progres të ulët të drejtorisë, që kanë dështuar edhe me ndërhyrjet e mëparshme të drejtorisë (mbi 5 vite e tjera).
- Të kërkojmë ndërhyrje nga i gjithë komuniteti shkollor në përcaktimin e zgjidhjeve të duhura për secilën shkollë të zgjedhur për ndryshim.
- Të sigurojmë një vit tranzicioni në trainim, burime dhe mbështetje për të përgatitur ekonomatë të operojnë me efektivitet në shkollat me progres të ulët dhe sigurojmë një tranzicion të butë.
- Të përcaktojmë shkollat për ndryshim me një partner të jashtëm ose program ndërhyrës të drejtorisë dhe të realizojmë kontrata të cilat përcaktojnë synimet vjetore që duhen kapur për mbetur një shkollë në funksion.
- Të përfundojmë revizione të rezultateve vjetore të shkollave në ndryshim, për të lehtësuar progresin drejt arritjes së objektivave të vendosura për shkollat.

- Të rinovojmë ose anullojmë marrëveshjet/kontratat me shkollat duke u mbështetur në të dhënat e rezultateve. (Ekonomatët e shkollave në ndryshim duhet të arrijnë objektivat vjetore të drejtorisë për tre vjet rrjesht që të sigurojnë një kontratë të dytë).

Njehsimi i Standardeve të larta për të gjitha shkollat

Ne do të vendosim standarde të larta dhe të qëndrueshme për të gjitha shkollat dhe monitorojmë progresin për t'i siguruar këto rezultate.

- Të përdorim deftesat shkollore, të dhënat e rezultateve të nxënësve dhe analizat cilësore të shkollave për të kategorizuar të gjithë Drejtorinë, shkollat çartër dhe ato me kontratë, duke u bazuar në aftësinë e tyre për përmirësim të rezultateve të nxënësve.
- Të zbatojmë një sistem vlerësimi të shkollave për të ndihmuar prindërit të krahasojnë progresin me shkolla të tjera të ngjashme të drejtorisë.
- Të monitorojmë arritjet çdo vit për të gjitha shkollat në ngritjen e rezultateve të nxënësit për të gjithë nxënësit dhe t'ia publikojmë komunitetit, para fillimit të vitit shkollor.
- Të informojmë nxënësit, prindërit, shkollat dhe komunitetin pse Drejtoria po vendos standarde të larta për shkollat dhe si ky standard do të përmirësojë arritjet e nxënësve të Filadelfias.

Shkolla e të Ardhmes

Ne do të punojmë me shkollat çartër, organizatat e menaxhimit të arsimit, individë, organizata të tjera, institucione të arsimit të lartë, dhe përqafojmë risi të bazuar në rezultate, që përmbushin nevojat akademike dhe programatike të Drejtorisë.

- Të partnerizojmë me individë që kanë dhënë prova dhe operatorë shkollorë (të drejtorisë dhe organizata të jashtëme) për projektuar tipe shkollash të reja dhe zgjeruar opsionet e sukseshme shkollore.
- Harmonizojmë modelet e shkollave të suksesshme me nevojat e drejtorisë për t'u shërbyer të gjithë fëmijëve.
- Të inkurajojmë dhe mbështesim zhvillimin e opsioneve krijuese shkollore që përmbushin nevojat dhe lehtësojnë ndarjen e eksperiencave/praktikave më të mira mes të gjithë formave të shkollave.

Personel arsimor i shkëlqyer

Përfytyroni...

- Një drejtori që fillon çdo vit shkollor e kompletuar me personel mësimor me efektivitet të lartë
- Një drejtori që rekruton dhe mban mësuesit, drejtorët, personelin mbështetës dhe menaxhuesit më të mirë dhe të mprehtë.
- Një drejtori që siguron mundësi në vazhdimësi për avancimin e aftësive të stafit të saj, talenteve dhe ekspertizës që t'u shërbejë më mirë nxënësve.

Rekrutimi dhe mbajtja e një personeli mësimor të mirë varet nga . . .

Rekrutimi i më të Mirëve

Ne do të fillojmë çdo vit shkollor të kompletuar me punonjës cilësorë, të cilët reflektojnë diversitetin e nxënësve tanë.

- Të ndryshojmë afatin e rekrutimit nga Gushti në Qershor për të plotësuar vendet vakantë në kohën e duhur, para fillimit të vitit shkollor
- Të ndryshojmë afatin për mësuesit e drejtorisë që transferohen në Maj.
- Të vendosim afate kohore që drejtuesit dhe administratorët të njoftojnë drejtorinë, nëse dhe kur mësuesit e tyre dalin në pension për atë vit. Të japin shpërblime për ata punonjës, të cilët janë të rregullt me datën e njoftimit dhe pasoja për ata që nuk zbatojnë afatet.
- Të zhvillojmë një proces me aplikantët nga shkollat e degëve të arsimit në kolegjet dhe universitetet, që fillojnë kur nxënësit janë në vitin e dytë.
- Të identifikojmë mësuesit dhe drejtorët mjeshtër, të cilët do shërbejnë si rekrutë për të kryer intervista në shkolla dhe ofrojnë kontrakta në konferenca kombëtare, shtetërore dhe vendndodhjet e arsimit.
- Të instalojmë një sistem për ndjekjen e aplikimeve.
- Të projektojmë dhe organizojmë rregullisht rekrutime në Zyrën Qendrore të arsimit dhe programe për rekrutimin paraprak që do të përfshijë intervista, letra përkushtimi të kandidatëve dhe mbikeqyrjen e programeve të zhvillimit dhe praktikës mësimore të mësuesve nga drejtoria qendrore.

- Të projektojmë një program të njëjtë “Të japim mësim në Filadelfia” (Teach in Philadelphia), që tërheq individë të profesioneve të tjera (si inxhinierë, art dhe shkencë); të hapim rrugë drejt marrjes së certificate të mësuesit (p.sh., përgatitjes së testeve Praxis, çertifikatës së praktikantit) dhe punësimit; dhe zbatojmë partneritete me universitetet.
- Të projektojmë një program shpërblimi për rekrutimin nxënës të shkollave të mesme të cilët duan të mësojnë në shkollat tona
- Të lidhim kontrata të gjata për arritjet, me programet “New Teacher Project” dhe “Teach for America”.
- Të projektojmë dhe zbatojmë një program orientimi që do të përgatisë të punësuarit e rinj të kuptojnë kulturën e drejtorisë.
- Të projektojmë një program për personelin e drejtorisë që të marrin çertifikatën për të rritur numrin e mësuesve më ngjyrë.

Të Ruajmë Personelin Cilësor

Ne do të zbatojmë një program zhvillimi talentesh të gjithanshëm që plotëson nevojat e ndryshme të gjithë personelit.

- Të krijojmë Zyrën e Problemeve të Mësuesve për të mbështetur mësuesit e drejtorisë nga fillimi i punës deri në daljen në pension.
- Të zhvillojmë takime mujore rreth tryezës së rrumbullakët mësues-superintendente me qëllim që të krijojmë një dialog në vazhdimësi mes të dyja grupet për të siguruar se shqetësimet, idetë dhe mbështetja dëgjohet dhe vihet në veprim.
- Të ngrejmë një Program Ndhmës mes Kolegësh për mësuesit e rinj dhe që bëjnë përpjekje.
- Të kryejmë kualifikime profesionale cilësore për të gjithë personelin e shkollës.
 - Të zhvillojmë një anketë vjetore të gjërë për të identifikuar nevojat në zhvillim të gjithë punonjësve, duke përfshirë stafin mbështetës, dhe të përdorim rezultatet për konturimin e ofertave në të ardhmen.
 - Të projektojmë dhe zbatojmë themele drejtimi për të gjithë mësuesit, administratorët, personelin menaxhues, dhe të gjithë ata që aspirojnë për pozicione lidheshipi në Drejtori. Institucionet e drejtorisë, të vendndodhura në rajone të ndryshme për të mundësuar marrjen e informacionit nga mësuesit, do të realizojnë trainime në vazhdim pas shkolle, të Shtunave dhe gjithë verën.
 - Të kryejmë programe trainimi teknik dhe periodike (buxhetin, politikat e HR (punësimit), Mardhëniet e Punonjësve, menaxhimin e mbajtjes së të dhënave) për të gjithë punonjësit.

- Të zbatojmë një sistem online për të ekspozuar aktivitetet për të gjithë personelin e drejtorisë.
- Të zhvillojmë një plan të gjërë, të kordinuar kualifikimi profesional për trajnimin e të gjithë stafit në implementimin e praktikave më të mira të mësimdhënies (mësuesve, drejtorëve, e personelit mbështetës).
- Të identifikojmë mësuesit më të shquar në mësimdhënie dhe që do të jenë të gatshëm për orë mësimi të hapura, një mundësi për mësuesit që kanë vështirësi.

Shpërblime për Arritje të Larta

Ne do të ruajmë mësuesit, drejtorët dhe personelin mbështetës cilësor me programe dhe procese që shpërblejnë dhe inkurajojnë talentet, arritjet e larta dhe udhëheqje në vazhdimësi.

- Të bëjmë të njohur një program ri-imbursimi shërblimi për pagesat e shkollave
- Të vendosim një program për faljen e huasë së shkollës së mësuesit
- Të projektojmë dhe zbatojmë një sistem me shpërblime financiare dhe jo-financiare për mësuesit (5-vjet e lart në sistem) të identifikuar si mësues me rezultate të larta dhe efektivitet të lartë, përmes honorareve dhe shpërblimeve publike, dhe mundësive të financimit për ngritje personale dhe profesionale (si p.sh., Instituti i Drejtorëve të Harvardit, leje e zgjatur e përcaktuar qartë dhe me qëllim, konferenca dhe forume në internet).
- Të projektojmë dhe zbatojmë programe për mësuesit, drejtorët dhe të tjerët për shkëmbimin e eksperiencave pozitive me kolegët e tyre.
- Të projektojmë dhe zbatojmë një shkallë kompesimi të diferencuar për mësuesit cilësorë, drejtorët dhe personelin për të dhënë shpërblime për përmbushjen e nevojave kritike në shkollat me vështirësi dhe fushat e lëndëve që është e vështirë të plotësohen me mësues (p.sh., ESL, matematikë, shkencë, gjuhët e huaja, e tjera).

Shërbim Qytetar i Përsosur

Ne do të sigurojmë që departamenti i shërbimeve humane të ofrojë një shërbim të përsosur.

- Të zbatojmë një plan përmirësimi për departamentin HR.
- Të kryejmë trajnime dhe ritrajnime lidhur me shërbimin për qytetarët.
- Të projektojmë një anketë mbi eksperiencën e shërbimit për të vlerësuar efektivitetin e departamentit dhe ku të jepen drejtime për ndryshim.
- Të rishikojmë dhe çojmë më tej cilësinë e linjës direkte të Drejtorisë.

Përgjegjësia e të Rriturve

Përfytyroni...

- Një drejtori ku punonjësit besojnë se puna e tij/saj lidhet direkt me pikësynimet dhe misionin themelor të drejtorisë.
- Një drejtori ku çdo punonjës kupton se çfarë pritët nga ata
- Një drejtori ku arritjet e shkëlqyera shpërblehen dhe mediokriteti është i patolerueshëm

Përgjegjësia e të rriturve varet nga . . .

Sistemi mates i arritjeve për të gjitha shkollat dhe drejtoritë

Ne do të matim dhe vlerësojmë arritjet e të gjitha drejtorive dhe individëve nga rezultatet e objektivave strategjike të drejtorisë.

- Të kthejmë objektivat strategjike në objektiva matëse të realizueshme në nivel drejtorie. Në krijimin e këtij sistem matës të ri, ne do të ndërtojmë në Deftesat shkollore ekzistuese dhe përfshijmë dy pikësynime: absolute (arritjet kundrejt standardeve objektive) dhe relative (arritjet kundrejt grupit).
- Të vendosim pikësynime dhe objektiva për çdo matës të arritjeve, që janë sfidante por edhe të arritshme.
- Të zhvillojmë një miks treguesish të avancuar dhe të prapambetur, që pasqyrojnë një balancë midis arritjet e mëparshme me ato aktuale matëse të progresit drejt pikësynimeve të arritshme.
- Të përçojmë pikësynimet e arritura të mbarë drejtorisë përmes organizatave nga rajoni/në shkolla/drejtori dhe deri tek individi.
- Të përcaktojmë lidhjet dhe nënvarësitë midis departamenteve, që duhen të përmbushin me sukses pikësynimet e arritjeve.
- Të investojmë në infrastrukturën e të dhënave dhe teknologjisë për të lehtësuar administrimin e sistemit të menaxhimit të arritjeve

Një Vlerësim i plotë i lidhur me Arritjet e Objektivave

Ne do të zhvillojmë dhe zbatojmë një sistem vlerësimi me shpërblime dhe pasoja, që do e rrisin përgjegjësinë e personelit në përmbushjen e objektivave të arritjeve.

- Të krijojmë një program për njohjen publike dhe festimin e drejtorive dhe individëve me arritje të larta.
- Të japim shpërblime financiare për rezultate të larta mes individëve përmes rritjes në diferencimin e rrogës, bonuseve, dhe hapja e rrugëve për karrierë.
- Të ndërtojmë një sistem mbështetjesh shtesë për personelin që përpiqet, ku përfshihen kualifikime profesionale me pikësnyim, instruktimin, dhe burime shtesë.
- Të thjeshtojmë mekanizmat për heqjen e personelit me rezultate të ulta, të cilët nuk bëjnë përmirësim edhe pas ndihmës së dhënë

Raporte Vjetore mbi Progresin

Ne do të raportojmë rregullisht publikut progresin e drejtorisë në përmbushje të pikësnyimeve të saj

- Të caktojmë një plan të rregullt për rishikimin publik të arritjeve në përgjithësi të drejtorisë përfshirë një vlerësim të vitit shkollor në Gusht; shpallja e synimeve për vitin e ri shkollor në shtator dhe një raport i arritjeve për gjysmën e vitit në muajin shkurt.
- Të lehtësojmë mundësimin e publikut në njohjen me raportet e arritjeve të Drejtorisë, Rajonit, Shkollës, në websaitin e drejtorisë.

Standarde të Njejta Profesionalizmi

Ne do të vendosim standarde të njejta profesionale dhe përgjegjësinë për të siguruar që shërbimi cilësor ndaj qytetarit të jetë konsekuent në mbarë drejtorinë.

- Të përcaktojmë standarde minimale të pranueshme për të gjithë punonjësit në lidhje me profesionalizmin.
- Të investojmë në kryerjen e trainimeve të rregullta lidhur me mënyrën e shërbimit për të gjithë punonjësit
- Të ngulitim standarde shërbimi me objektiva të arritshme tek individi, shkollë/drejtori, rajon/njësi, dhe nivel distrikti
- Të vendosim objektiva të pritëshme për shërbimin qytetar me të gjithë përbërësit e drejtorisë përmes mekanizmave të komunikimit dhe marketingut.

- Të krijojmë një sistem menaxhimi të drejtorisë në postën elektronike për të ndjekur të gjitha kërkesat e qytetarit në kohë, dhe cilësi për çdo drejtori dhe shkollë.

Veprimtari Model

Përfytyroni...

- Një drejtori shkollore ku burimet shpërndahen drejtë dhe në mënyrë të barabartë për të gjitha shkollat
- Një drejtori arsimore ku të gjitha ndërtesat dhe mjediset e shkollave, oborret janë të pastra, tërheqëse dhe të mbajtuara mire në mënyrë të favorshme për një mësim dhe mësimdhënie efektive
- Një drejtori shkollore që gjithmonë është një shërbëtoare e mire e financave të publikut
- Një drejtori shkollore me numrin e duhur të ambjenteve, në vendndodhjen e duhur, dhe me një mjedis pozitiv për mësim

Kryerja e operacioneve model varet nga..

Plan i Përsosur për Ambjentet e Drejtorisë

Ne do të krijojmë një plan pesë-vjeçar të gjithanshëm dhe vazhdimisht modern të ambjenteve të drejtorisë. që përputhet me planin strategjik Përfytyro 2014

- Të sigurojmë sasinë e duhur të hapësirave duke zhvilluar kritere për rinovimin
- Të identifikojmë, sigurojmë zbatimin dhe fonde për ambjente të duhura dhe projekte moderne teknologjike.
- Të identifikojmë oportunitete për përdorim më eficient të hapësirave përmes bashkë vendosjes në një godinë të programeve, okupimin e mjediseve të tepërta të drejtorisë nga shkollat çartër dhe strategjitë për ndarje ambjentesh me njëri tjetrin

Ne do të mirëmbajmë dhe modernizojmë ambjentet e drejtorisë mbi baza të barabarta dhe të përgjegjshme

- Riprojektojmë një sistem mirëmbajtjeje të mjediseve, që në një shkallë të barabartë adopton standarde industriale për efikasitetin dhe praktikën më të mira për rinovimin

dhe riparimin e tyre; të zbatojmë strategji dhe procese pune që përmbushin e tejkalojnë keto standarde; dhe të përdorim të dhënat me të fundit për menaxhimin e resurseve, përmirësimin e efektivitetit.

- Të ndërtojmë një proces plani të përbashkët për krijimin, mbylljen, rikonfigurimin, rivendosjen dhe rinovimin e ambjenteve të drejtorisë që sigurojnë se të gjitha programet arsimore kanë hapësirat e duhura dhe adekuate, ku operohet në godina të përshtatshme për nxënësit dhe familjet e tyre.

Ne do të pajisim nxënësit dhe personelin me mjedise të teknologjisë së informacionit më të mirë që do të ngrejë më lart mësimin dhe përmirësojë rendimentin.

- Të ndërtojmë dhe operojmë me efikasitet networkun e telekomunikacionit dhe informacionit të mbarë drejtorisë, mësimdhënies dhe proceset e punës në mënyrën më efektive dhe të përshtatshme.
- Të pajisim shkollat me infrastrukturën e nevojshme për mbështetjen e klasave të programit shekulli 21.
- Të përfitojmë, ose krijojmë kur është e mundur, media dhe aplikacione për mësimdhënien, që mundësojnë arsimtarët për të qënë më efektiv në mësim dhe treinojmë mësuesit për të përdorur këto media dhe aplikime me efikasitet më të lartë.

Operacione Harmonike dhe Efektive

Ne do t'i harmonizojmë operacionet e shërbimit dhe biznesit për të minimizuar shpenzimet, shtojmë në maksimum efektshmërinë, sigurojmë një shërbim të shkëlqyer, që mbështet barazinë në ndarjen e burimeve.

- Të ndërtojmë pikësnyime me arritje të qarta, për të gjitha njësitë operative dhe financave që ngrejnë efektshmërinë dhe transparencën; monitorojmë arritjet aktuale; krahasojmë arritjet me objektivat; dhe zhvillojmë e zbatojmë strategjitë për përmirësimin e këtyre arritjeve.
- Rishikojmë politikat ekzistuese dhe procedurat për të eliminuar punët e kota, dublimet dhe shpejtojmë kohën e procedimit të transaksioneve.
- Të modernizojmë sistemet aktuale financiare, të lehtësojmë përdorimin, mundësojmë integrimin me sisteme të tjera të drejtorisë, sigurojmë informacion në kohë, dhe ulim kohën e shpenzuar në punët administrative.
- Të mundësojmë që operuesit e drejtorisë të blejnë shërbime biznesi nga kompani të ndryshme, gjë që do të çojë në përmirësimin e cilësisë dhe uljes së shpenzimeve.

- Të negociojmë dhe menaxhojmë kontrata të shitësve të jashtëm në mënyrë që të marrim cilësinë më të lartë dhe çmimin më të ulët, të monitorojmë vazhdimisht dhe vlerësojmë efektshmërinë e shitësve në përmbushjen e objektivave arsimore dhe operative të drejtorisë.
- Të sigurojmë që, të gjitha palët shitëse të kualifikuara të kenë një mundësi të barabartë për biznes me Drejtorinë Arsimore, dhe të inkurajojmë rritjen e ndërrmarjeve të biznesit operuar nga gratë dhe minoriteti.

Ne do të ushqejmë komunikimin e hapur, e të vazhdueshëm midis stafit edukues dhe atij operacional për krijimin e një kulture të ndarjes së përgjegjësisë në mbështetjen e nje ambjenti mesimor efektiv.

- Të rritim bashkëpunimin, komunikimin midis drejtuesve dhe personelit akademik, administrative dhe financiar të drejtorisë për të siguruar që burimet janë shpërndarë dhe përdorur në një mënyrë që përparon objektivat kritike të drejtorisë, arritja matet dhe përmirësohet, dhe shërbimi qytetar sigurohet.
- Të bëjmë shërbimin qytetar një element kyç në vlerësimin dhe shpëblimin të arritjeve për menaxhuesit dhe personelin financiar dhe operativ.

Buxhete të Balancuara, që përputhen me Objektivat e Drejtorisë

Ne do të zhvillojmë dhe zbatojmë buxhete vjetore të balancuara që mbështeten dhe përputhen me objektivat dhe strategjitë e drejtorisë.

- Të monitorojmë vazhdimisht shpenzimet aktuale nga viti në vit dhe t'i krahasojmë me buxhetin.
- Të identifikojmë dhe korigojmë mospërputhjet e buxhetit aktual të projektuar në një mënyrë që, nuk dëmton progresin arsimor të drejtorisë.
- Të raportojmë tek publiku dhe fondet e dhëna nga qeveritë për drejtorinë se si janë përdorur burimet e drejtorisë në mënyra që janë qarta, transparente dhe informuese.

Ndarja e fondeve shkollore varet nga nxënësi

Ne do t'i allokojmë burimet e drejtorisë shkollave gjatë procesit të buxhetit vjetor me anë të një procesi transparent dhe të barabartë, me burime shtesë të allokuara në ndihmë të nxënësve me nevoja sinjifikative, për të arritur në të njëjtat nivelel me nxënësit e tjerë.

- Të rishikojmë dhe përmirësojmë metodologjinë e buxhetit shkollor të drejtorisë për të siguruar barazi në shpërndarje të burimeve financiare.

- T'u japim drejtorëve të shkollave dhe ekipeve drejtuese të shkollave, përfshirë mësuesve dhe prindërve, oportunitete domethënëse që ndihmojnë në konturimin e buxhetit të shkollave dhe që do ndihmojnë në përmirësimin efektive dhe në efikasitet të operacioneve shkollore dhe ngrejë më lart arritjet e nxënësve

Hapat e tjerë

Duke kërkuar një ndërhyrje të gjërë të komunitetit, ne po planifikojmë një numër hapash të tjerë, ku prindërit, mësuesit dhe publiku i gjërë mund të na ndihmojnë në formulimin e prioriteteve strategjike pesë-vjeçare të drejtorisë arsimore.

Grupet e punës

- 23 Shkurt, ora 6-8pm (440 North Broad)

Takimet me Komunitetin

- Ne do të planifikojmë një seri takimesh me komunitetin gjatë muajit Mars dhe fillimit të muajit Prill

Sesione dëgjimore

- Në vazhdim të takimeve me komunitetin ne do takohemi me prindër, mësues, drejtues shkollash dhe grupe të tjera të interesuara.

Komisioni i Reformës Shkollore në votim për planin strategjik

- 15 Prill

Për më shumë detaje për takimet në të ardhmen, ju lutemi vizitoni Websaitin tonë: www.philasd.org/strategicplan. Ose kontaktoni Jennie Wu, jwu@philasd.org, në numrin e telefonit 215-400-6989.